

01/ 23/OP/24



## K E R K E S E

PER KONSTATIMIN DHE DEKLARIMIN E PAMUNDESISE SE VENIES NE EKZEKUTIM TE VENDIMIT NR.95 DATE 23.07.2014 TE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE PER KRIMET E RENDA TIRANE, PASI LIGJERISHT REZULTON I PAVLEFSHEM, SI DHE PER FAKTIN QE URDHERI I PROKURORIT PER VENIEN NE EKZEKUTIM TE KETIJ VENDIMI, NUK EKZISTON.

Kerkues:

Dritan Dajti, i biri i Hasanit dhe i Aferditës, i datelindjes 17.11.1971, lindur dhe banues ne Tirane, me arsim të lartë, me gjëndje civile i martuar, me shtetësi e kombësi shqiptare, aktualisht i burgosur prane I.E.V.P. Peqin, perfaqesuar nga av.Alban Kapxhiu.

Objekti:

1. Konstatimi dhe deklarimi i pamundesise se venies ne ekzekutim te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014, te Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, ne ngarkim te shtetasit **Dritan Dajti**, per shkak se ligjerisht ky Vendim eshte i pavlefshem si dhe per faktin qe urdheri i prokurorit per venien ne ekzekutim te ketij Vendimi, nuk ekziston.

2. Konstatimi i heqjes se lirise me burgim ne rruge jashtegjyqesore, lidhur me vendimin e mesiperm me Nr.95, date 23.07.2014.

3. Marrja e vendimit brenda 48 oreve per ligjshmerine e kesaj mase te marre nga I.E.V.P. Peqin, ndaj shtetasit **Dritan Dajti**.

Baza Ligjore:

Nenet 4, 27/1, 28 Pika 4, te Kushtetutes dhe Neni 471 i K.Pr.Penale.



Ne keto kushte, konkludojme qe ndodhemi perballe shkeljeve flagrante te ligjit dhe cenimit te garancise e sigurise juridike; parime themelore keto te sanksionuara ne Nenin 4 dhe Nenin 28/4 te Kushtetutes, ku respektivisht thuhet:

1. E drejta perbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.
2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

**Kapitulli III.** Parshtime lidhur me konstatimin e faktit qe Urdheri i Prokurorit per venien ne ekzekutim te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014 te Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, nuk ekziston.

Ne Nenin 27/1 te Kushtetutes, sanksionohet:

*Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.*

Ne rastin konkret procedura e parashikuar ne ligj per heqjen e lirise me burgim te shtetasit Dritan Dajti, eshte ajo e Nenit 12 te Ligjit Nr.79/2020 PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE, ku shprehimisht thuhet:

Urdhri i ekzekutimit është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal.

Perkunder sa siper, shtetasi Dritan Dajti mbahet i burgosur ne I.E.V.P. Peqin, pa Urdherin e Prokurorit per venien ne ekzekutim te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014 te Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane. Ky fakt eshte pranuar dhe konfirmuar zyrtarisht nga Drejtori i I.E.V.P.Peqin, me Shkresen Nr.6226 Prot., date 22.08.2024, ku shprehimisht thote:

P E R P A R A  
GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TE JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM  
E L B A S A N

E nderura Gjykate!

Shtetasit Dritan Dajti, si askujt tjetër deri me sot, i është hequr liria dhe po mbahet i burgosur prej 1 muaji në rrugë jashtëgjyqësore nga autoritetet e I.E.V.P.Peqin, në shkelje flagrante të Neneve 4, 27 dhe 28 të Kushtetutës:

- Me një vendim denimi me burgim të përjetshëm, të cilin ligji e konsideron të pavlefshëm për shkak se i mungojnë nënshkrimet e katër anëtarëve të trupit gjykues;
- Si dhe për faktin që Urdhëri i Prokurorit për vendien në ekzekutim të këtij Vendimi, nuk ekziston.

**Kapitulli I. Fakte e rrethana.**

Me 23 Korrik 2014, me Vendim Nr.95, Gjykata e Shkalles së Pare për Krime të Renda Tirane ka shpallur fajtor dhe ka dënuar të pandehurin Dritan Dajti me "burgim të përjetshëm", për kryerjen e katër here të veprës penale "Vrasje në rrethana të tjera çilesuese", ndaj punonjësve të policisë Fatos Xhani, Sajmir Duçkollari, Altin Dizdari dhe Kastriot Feskaj, parashikuar nga Neni 79, Pika "c" i Kodit Penal.

Me 01 Dhjetor 2014, me Vendim Nr.122, Gjykata e Apelit për Krime të Renda Tirane, ka vendosur "Prishjen e vendimit Nr.95, datë 23.07.2014, të Gjykates për Krime të Renda, Tirane dhe kthimin e akteve për rigjykim, në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues".

Me 13 Korrik 2016, me Vendim Nr.153 (1220), Kolegji Penal i Gjykates së Lartë ka vendosur "Prishjen e vendimit Nr.122, datë 01.12.2014 të Gjykates së Apelit për Krime të Renda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues".

Me 08 Shkurt 2019, me Vendim Nr.13, Gjykata e Apelit për Krime të Renda, ka vendosur:

1. Lenien në fuqi të vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykates së Shkalles së Pare për Krime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE  
INSTITUCIONI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PEQIN

Nr. 6226 Prot

Peqin, më 22.08.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Të dënuarit Dritan DAJTI

I akomoduar në Sektorin Nr.4, Kati Nr. 2, Dhoma Nr.8, Godina "B", IEV Penale Peqin

U njohëm me kërkesën tuaj të regjistruar në Regjistrin e kërkesë - ankesave të të dënuarve me Nr.6432 Prot datë 22.08.2024 ku na keni kërkuar kopje të urdhërit të ekzekutimit të Vendimit Nr.95 datë 23.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Ju informojmë se nga verifikimi i akteve të administruara në dosjen penale nuk rezulton që të jetë i inventarizuar urdhër ekzekutimi, për vendimin penal me Nr.95 datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORI I INSTITUCIONIT  
Florenc DOKA



Nga verifikimi i akteve te administruara ne dosjen penale, nuk rezulton qe te jete i iventarizuar urdher ekzekutimi, per vendimin penal me Nr.95 date 23.07.2014, te Gjykates e Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane.

#### Kapitulli IV.

Parashtrime lidhur me faktin qe Vendimi i arsyetuar i Kolegjit Penal te Gjykates se Larte Nr.00-2024-1069 (140), date 11.06.2024, parashikon qarte proceduren e ekzekutimit te Vendimit Nr.95, date 23.07.2014.

Me Shkresen Nr.756/5 Prot., Prokuroria e Pergjithshme i ka derguar Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, Vendimin e arsyetuar te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte Nr.00-2024-1069 (140), qe kish vendosur ne date 11.06.2024, Prishjen e vendimit nr.13 date 08.02.2019 te Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.95, date 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vlen te theksohet fakti qe ne fund te kesaj shkrese, lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, date 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, shprehimisht thuhet: Sqarojme se, ky vendim ju dergohet, bazuar ne percaktimet e bera ne vendim e mesiperm (paragrafi 84 i vendimit te arsyetuar).

Duke ju referuar pargrafi 84 te Vendimit ne fjale te Gjykates se Larte, konstatojme qe lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, date 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Kolegji Penal deklaroi shprehimisht se:

Me ekzekutimin e vendimeve në baze të ligjit nr. 79/2020 "Per ekzekutimin e vendimeve penale", do te jene prokurorite prane gjykatave te juridiksionit te pergjithshem sipas kompetences tokesore, neni 76 i KPP, te vendit ku ka ndodhur vepra penale ne kete rast ose vendit ku ekzekutohet vendimi.

Kapitulli V. Parashtrime lidhur me respektimin e rregullave procedurale ne paraqitjen e kerkeses.

Kerkesa eshte paraqitur ne respekt e zbatim te Nenit 471/1-2 te K.Pr.Penale, ku shprehimisht thuhet:

*Gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit.*

Off 23/OP/24



## K E R K E S E

PER KONSTATIMIN DHE DEKLARIMIN E PAMUNDESISE SE VENIES NE EKZEKUTIM TE VENDIMIT NR.95 DATE 23.07.2014 TE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE PER KRIMET E RENDA TIRANE, PASI LIGJERISHT REZULTON I PAVLEFSHEM, SI DHE PER FAKTIN QE URDHERI I PROKURORIT PER VENIEN NE EKZEKUTIM TE KETIJ VENDIMI, NUK EKZISTON.

Kerkues:

Dritan Dajti, i biri i Hasanit dhe i Aferditës, i datelindjes 17.11.1971, lindur dhe banues ne Tirane, me arsim të lartë, me gjëndje civile i martuar, me shtetësi e kombësi shqiptare, aktualisht i burgosur prane I.E.V.P. Peqin, perfaqesuar nga av.Alban Kapxhiu.

Objekti:


1. Konstatimi dhe deklarimi i pamundesise se venies ne ekzekutim te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014, te Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, ne ngarkim te shtetasit **Dritan Dajti**, per shkak se ligjerisht ky Vendim eshte i pavlefshem si dhe per faktin qe urdheri i prokurorit per venien ne ekzekutim te ketij Vendimi, nuk ekziston.

2. Konstatimi i heqjes se lirise me burgim ne rruge jashtegjyqesore, lidhur me vendimin e mesiperm me Nr.95, date 23.07.2014.

3. Marrja e vendimit brenda 48 oreve per ligjshmerine e kesaj mase te marre nga I.E.V.P. Peqin, ndaj shtetasit **Dritan Dajti**.

Baza Ligjore:

Nenet 4, 27/1, 28 Pika 4, te Kushtetutes dhe Neni 471 i K.Pr.Penale.



Me 22 Gusht 2024, I.E.V.P. Peqin, me Shkresen Nr.6226 Prot., informon zyrtarisht kerkuesin Dritan Dajti se nuk ekziston urdheri i prokurorit per venien ne ekzekutim te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014 te Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane. Konkretisht, ne kete shkrese shprehimisht thuhet:

*Nga verifikimi i akteve te administruara ne dosjen penale, nuk rezulton qe te jete i iinventarizuar urdher ekzekutimi, per vendimin penal me Nr.95 date 23.07.2014, te Gjykates e Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane (lidhja 4).*

Me 19 Gusht 2024, me Shkresen Nr.3392 Prot., autoritetet e I.E.V.P. Peqin i kane vene ne dispozicion av. **Alban Kapxhiu**, Dinamiken e Vuajtjes se Denimit te kerkuesit Dritan Dajti te llogaritur deri daten 11.06.2024, ku shprehimisht thuhet:

*Me Vendimin nr. 1108, date 11.05.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: Bashkimin e dënimeve për të dënuarin Dritan Dajti të dhëna ndaj tij me Vendimin penal Nr. 146 date 17.03.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane me te cilin është dënuar me 23 vjet burgim, dhe të Vendimit penal Nr. 13 date 08.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Renda Tirane me të cilin është dënuar 25 vjet burgim, në një dënim të vetëm, duke e dënuar Dritan Dajtin përfundimisht me 25(njezet e pesë) vite burgim.*

*Vendimi ka marre formë të prere me datë 26.05.2020.*

*Nga dënimi dhënë ka vuajtur 24 vjet 09 muaj 24 ditë.*

*Nga dënimi i dhënë mbeten për të vuajtur 2 muaj 06 ditë.*

*Perllogaritjet jane bere me date 11.06.2024 (lidhja 5).*

Pra sipas dinamikës së mesiperme te vuajtjes se denimit te perllogaritur me date 11.06.2024, rezulton se:

Shtetasi Dritan Dajti, qe prej dates 17.08.2024, ka perfunduar ekzekutimin e vendimit të dënimit te tij me 25 vjet burgim sipas Vendimit Nr.1108, date 11.05.2020, te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Me 04 Shtator 2024, autoritetet e I.E.V.P. Peqin, me Shkresen Nr.3484 Prot., kane informuar zyrtarisht shtetasin Dritan Dajti se mbahet i burgosur ne ate Institucion per shkak te Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane (lidhja 6).

Kur kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrefuzuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe, gjykata, pasi dëgjon prokurorin e deklaron atë të papranueshme me vendim, i cili i njoftohet brenda pesë ditëve të interesuarit. Kundër vendimit mund të bëhet ankim.

Siç u parashtrua edhe me lartë, kërkesa nuk është haptazi e pabazuar pasi është paraqitur në respekt të zbatimit të nenëve 4, 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe nuk është përsëritje e një kërkesë të rrefuzuar me pare pasi është hera e parë që Dritan Dajti paraqet një kërkesë të tillë përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

## Kapitulli VI. Konkluzione.

Nisur nga argumentet, objeksionet dhe observimet e parashtruara, si dhe në respekt të zbatimit të Nenëve 4, 27/1, 28/4 të Kushtetutës dhe Nenit 471 të K.Pr.Penale;

### K e r k o j m e :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin dhe deklarimin e pamundësisë së venies në ekzekutim të Vendimit Penal Nr.95, datë 23.07.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Renda Tirane, në ngarkim të shtetasit Dritan Dajti; për shkak se ligjërisht ky Vendim është i pavlefshëm, si dhe për faktin që Urdhëri i Prokurorit për venien në ekzekutim të këtij Vendimi, nuk ekziston.
3. Konstatimi i heqjes së lirise me burgim në rrugë jashtëgjyqësore lidhur me vendimin e mesipërme Nr.95, datë 23.07.2014.
4. Marrja e vendimit brenda 48 orëve për ligjshmerinë e kesaj mase të marre nga I.E.V.P. Peqin, ndaj shtetasit Dritan Dajti.

Peqin me 23 Shtator 2024.

Me Konsiderate





Me 20 Shtator 2024, nepermjet av.Alban Kapxhiu, Drejtori i I.E.V.P. Peqin z.Florenc DOKA, me Shkresen Nr.3683 Prot., i ka vene ne dispozicion shtetasit Dritan Dajti Vendimin Penal Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane. Ne kete shkrese shprehimisht thuhet:

*Në përgjigje të shkresës tuaj bashkëlidhur po ju dergojmë Kopje të njëhsuar me originalin te Vendimit Nr.95 date 23.07.2014 te Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.*

Sa siper, pasi u njohem me Kopjen e njesuar me origjinalin te Vendimit Penal Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, konstatuam qe **ketij Vendimi i mungojne nenshkrimet e kater anetareve te trupit gjykues;**

1. Gjyqtares Liljana Baku;
2. Gjyqtarit Ardit Mustafaj;
3. Gjyqtares Flora Hajredinaj
4. Gjyqtarit Fran Prendi (lidhja 7).

**Kapitulli II.** Parshtime lidhur me konstatimin e faktit qe Vendimit Penal Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, rezulton i pavlefshem dhe si i tille nuk mund te ekzekutohet.

Vendimit Penal Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane ne ngarkim te shtetasit Dritan Dajti, **nuk mund te vihet ne ekzekutim per shkak se ai rezulton i pavlefshem, ne respekt zbatim te Nenit 383/ Pika 1-“dh” dhe Pika 2 te K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht:**

*Vendimi përmban datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.*

*Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues.*

Siç rezulton ne fakt, Vendimit Penal Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane i mungojne nenshkrimet e kater anetareve te trupit gjykues; gjyqtares Liljana Baku; gjyqtarit Ardit Mustafaj; gjyqtares Flora Hajredinaj dhe gjyqtarit Fran Prendi.

3 tipi RH-105 nr.IME  
00 tipi RH-99 nr.IME  
00 tipi RH-99 nr.IME

- 13.Një bluzë e kufomës së shtetasit Altin Dizdari.
- 14.Një bluzë dhe një palë pantallona të shtetasit Kastriot Feskaj.
- 15.Një kapele ngjyrë blu me mbishkrimin DEA së bashku me një xhup feshje me mbishkrimin policia në një zarf të bardhë.

e.Të asgjesohen:

USB Flash Drive ngjyrë vishnje marka Apacer, dokument identifikimi Qendra e Studimeve të Luftës Kundër Terrorizmit Krimin të Organizuar Ergest Xhoxhi, mbështjellë me kapak plastik ngjyrë të zezë, kapuç ngjyrë e zezë, material nailon si ato të çorapeve të femrave.

Bazuar në nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale deklarohen si të falsifikuara dhe të asgjesohen provat si më poshtë:

- 1.Një dokument i Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit me emër të Astrit Agron Zeneli me gradë N/komisari lëshuar nga D.P.Q Korçë me numër serie 5340208-98, 25687.
- 2.Një dokument identifikimi i policisë së shtetit me numër identifikimi 7817103 në emër të Astrit Zeneli lëshuar me datë 22.07.2008, grada N/komisar D.P.Q Korçë.
- 3.Leje drejtimi të Republikës Italiane në emër të shtetasit Astrit Zeneli e kategorisë "B".
- 4.Dokument identifikimi fletë hyrje për të hyrë në Drejtorinë e Policisë Korçë në emër të Astrit Hasan Zeneli grada inspektor.
- 5.Dokumentat përkatëse të autoverurës tip Wolswagen TUAREG, ngjyrë e zezë foristradë me targë CR 535 FR së bashku me targën.

Shpenzimet proceduriale të bëra si gjatë hetimit ashtu dhe gjatë gjyqimit në masën që janë kryer në ngarkim të pandehurit.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga palët brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, me datë 23.07.2014.


SEKRETARE

Blerina SUKAJ



GJYQTAR

Idriz MULKURTI



Kur kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrezuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe, gjykata, pasi dëgjon prokurorin e deklaron atë të papranueshme me vendim, i cili i njoftohet brenda pesë ditëve të interesuarit. **Kundër vendimit mund të bëhet ankim.**

Siç u parashtrua edhe me larte, kërkesa nuk është haptazi e pabazuar pasi është paraqitur në respekt të zbatimit të nenëve 4, 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe nuk është përsëritje e një kërkesë të rrezuar me pare pasi është hera e pare që Dritan Dajti paraqet një kërkesë të tillë përpara Gjykatës së Shkalles së Pare të Juridiksionit të Pergjithshëm Elbasan.

## Kapitulli VI. Konkluzione.

Nisur nga argumentet, objeksionet dhe observimet e parashtruara, si dhe në respekt të zbatimit të Nenëve 4, 27/1, 28/4 të Kushtetutës dhe Nenit 471 të K.Pr.Penale;

### K e r k o j m e :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin dhe deklarimin e pamundësisë së venies në ekzekutim të Vendimit Penal Nr.95, date 23.07.2014, të Gjykatës së Shkalles së Pare për Krimet e Renda Tirane, në ngarkim të shtetasit **Dritan Dajti**; për shkak se ligjrisht ky Vendim është i **pavlefshëm**, si dhe për faktin që Urdheri i Prokurorit për venien në ekzekutim të këtij Vendimi, **nuk ekziston**.
3. Konstatimi i heqjes së lirise me burgim në rrugë jashtëgjyqësore lidhur me vendimin e mesiperm me Nr.95, date 23.07.2014.
4. Marrja e vendimit brenda 48 orëve për ligjshmerinë e kesaj mase të marre nga I.E.V.P. Peqin, ndaj shtetasit **Dritan Dajti**.

Peqin me 23 Shtator 2024.

Me Konsiderate



te Renda Tirane.

2. Ne aplikim te nenit 406/1 te K.Pr. Penale, i ndryshuar me ligjin 8813, date 13.06.2002, ne fuqi ne kohen e kryerjes se veprave penale, denimin perfundimisht te pandehurin **Dritan Hasan Dajti** me 25 vite burgim.

Me 13.03.2019, Prokurori **Isa Jata** ka ushtruar rekurs kunder Vendimit Nr.13, date 08.02.2019, te Gjykates se Apelit per Krime te Renda, duke kerkuar Prishjen e Vendimit Nr.13, date 08.02.2019, te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane dhe lenien ne fuqi te Vendimit Nr.95, date 23.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

Me 11 Qershor 2024, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.13 datë 08.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (lidhja 1).

Me 12 Qershor 2024, autoritetet e I.E.V.P.Peqin, i kane njoftuar shtetasit **Dritan Dajti** Vendimin e Kolegjit Penal te Gjykates se Larte si dhe Urdherin e Ekzekutimit te Prokurorit prane Prokurorise se Pergjithshme **Isa Jata** (lidhja 2).

Me 04 Korrik 2024, me Shkresen Nr.756/5 Prot., Prokuroria e Pergjithshme i ka derguar Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, Vendimin e arsyetuar te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte Nr.00-2024-1069 (140) (lidhja 3).

Vlen te theksohet fakti qe ne fund te kesaj shkrese, lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, shprehimisht thuhet: Sqarojme se, ky vendim ju dergohet, bazuar ne percaktimet e bera ne vendim e mesiperme (paragrafi 84 i vendimit te arsyetuar).

Duke ju referuar pargrafit 84 te Vendimit ne fjale te Gjykates se Larte, konstatojme qe lidhur me ekzekutimin e Vendimit Nr.95, datë 23.07.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Kolegji Penal deklaroi shprehimisht se:

Me ekzekutimin e vendimeve në baze te ligjit nr. 79/2020 "Per ekzekutimin e vendimeve penale", do te jenë prokurorite prane gjykatave te juridiksionit te pergjithshem sipas kompetences tokesore, neni 76 i KPP, te vendit ku ka ndodhur vepra penale ne kete rast ose vendit ku ekzekutohet vendimi.